Franci Qyteti / Qyteti

Alberto Brescia

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 1531/1 Prot. Vlorë më, 31.08.2023

**VENDIM**
**Nr.45, datë 31.08.2023**

**PËR**
**MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË IXHINIERI MEKANIKE , PROGRAM I PËRBASHKËT STUDIMI NË GJUHËN ANGLEZE, NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË BARIT, ITALI**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe proçedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre , njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të arsimit të Lartë", si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën nr.1521/1, prot datë 30.08.2023, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 31.08.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren e programit të studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekanike", program i përbashkët në gjuhën angleze, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit, Itali, ofruar nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**
**Prof.Dr. ROLAND ZISI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

## ZV REKTORI AKADEMIK

Nr. 1521/1 Prot. Vlorë më, 30/08 2023

**Lënda:** Relacion për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, program i përbashkët në gjuhën angleze, në bashkëpunim me POLIBARIN në Itali.

**PROF.DR. ROLAND ZISI**
**KRYETAR I SENATIT AKADEMIK**

Në kuadër të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e programit të përbashkët të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, program i përbashkët në gjuhën angleze, në bashkëpunim me POLIBARIN në Itali.,bazuar në udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020 mbi "Dokumentacioni dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të IAL, njësive kryesore dhe programeve të studimit", shkresës me Nr.1521 Prot, datë 30.08.2023 të Fakultetit " Përcjellje e draft- rregullores së Programit të Ciklit të Parë të Studimeve midis UV-së dhe Universitet Politeknik të Barit", në të ciliën paraqitet vendimi i Departamentit Inxhienierisë e Teknologjisë Detare për miratimin e draft rregullores të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri mekanike, programi i përbashkët në gjuhën angleze në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit, Itali.

Draft rregullorja është hartuar duke mbajtur në kosideratë:

1. Ligjin Nr 80/2015 datë 22/07/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.
2. Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave:"Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë.
3. Vendimin nr. 31, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave: "Për përcaktimin e kritereve për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë.
4. Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës
5. Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali të Vlorës.
6. Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

7. Rregulloren e Brendshme te Funksionimit dhe Organizimit te Departamentit te Inxhinierive dhe Teknologjise Detare.

Programi mësimor Diplomë e Përbashkët/Dyfishtë"Bachelor në Inxhinieri Mekanike", ne gjuhen angleze, është program i ciklit të parë të studimeve, ofruar nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit (PoliBa), në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy IAL-ve.
Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL-ve, me anë të këtij programi të dyja palët (UV dhe PoliBa) synojnë të ofrojnë një program ku studentët Bachelor nga Institucioni Vendas që ndjekin studimet në Bsc në Inxhinieri Mekanike do të parazgjidhen nga institucioni vendas për të përfunduar studimet e tyre Bachelor në institucionin pritës.
Në institucionin pritës, studentët pjesëmarrës do të ndjekin lëndët sipas programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike të institucionit pritës.
Referuar pikës I.A.5 të Marrveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL-ve, UV dhe PoiBa, të gjitha lëndët që do të frekuentohen nga studentët në Institucionin pritës do të jenë lëndë në nivel diplomimi dhe do të ofrohen në Italisht ose Anglisht për lendët që do frekuentohen në PoliBa, dhe në Anglisht për lëndët që do të frekuentohen në UV.
Referuar pikës I.A.8 të Marrveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL-ve, UV dhe PoiBa, studentët e pranuar të institucionittë origjinës do të paguajnë tarifat e shkollimit në institucionin e origjinës. Ata do të jenë përgjegjësvetëm për shpenzimet e tyre të udhëtimit, shpenzimet e jetesës dhe sigurimin mjekësor gjatë periudhës së studimit pënë institucionin pritës, së bashku me çdo shpenzim tjetër.
Draft rregullorja përcakton qartë organiyimin e programit i cili organizohet në tre vite akademikë (6 semestra)dhe në përfundim të tyre studentët grumbullojnë 180 ECTS dhe marrin diplomë: "Bachelor në Inxhinieri Mekanike", lëshuar në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy IAL-ve.
Draft rregullorja ka përcaktuar gjithashtu, objektivat formuese të programit të studimit. Programi i përbashkët/dyfishtë i studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekanike",ne gjuhen angleze midis UV dhe PoliBaka për qëllim që të formoj inxhinierë mekanike që të jenë në gjendje të konceptojnë, projektojnë, zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë makineri dhe sisteme mekanike të thjeshta dhe komplekse, që përdoren në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë kryesisht njohuri dhe kompetenca profesionale në disiplinat karakterizuese si me poshtë:

- Projektimin e Sistemeve Fluidike dhe Termike, duke përfshirë përshkrimin, funksionimin dhe karakteristikat e sistemeve fluide dhe termike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

ZV REKTORI AKADEMIK

- Mekaniken e Materialeve, duke përfshirë sforcimet, deformimet, lodhjen, thyerjen dhe faktorin e sigurisë.
- Projektimin e Sistemeve Mekanike, duke përfshirë filozofinë e projektimit, materialet inxhinierike, vetitë e tyre, sforcimet e thjeshta ne elementet e makinave, sforcimet përdredhëse dhe përkulëse, teoritë e shkatërrimit, lidhjet e ribatinuara, te salduara, lidhjet me fileto, me kiaveta, bashkueset, boshtet, enët në presion, sustat, kushinetat, rrotat e dhëmbëzuara.

Janë të përcaktuara në mënYrë të detajuar: Kuotat, tarifat dhe kriteret e pranimit të studentëve, rregullorja për pranmimin, trasferimin e krediteve për studentët, plani i detajuar mësimor, silabuset e lëndëve, sistemi i kontrollit e velërsimit etj.

Bashkëlidhur këtij relacioni gjeni shkresën e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore së bashku me draft rregulloren.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ZV REKTORI AKADEMIK
PROF.AS FROSINA QYRDETI

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS
Nr. 1521 PROT.
DATA 30.08.2023

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE**
**DEKANI**

Nr. 287/1 Prot.

Vlorë, më 30/08/2023

Lënda: Përcjellje e draft-rregullores së Programit të Ciklit të Parë të Studimeve midis UV-së dhe Universitetit Politeknik të Barit.

**KRYETARIT TË SENATIT AKADEMIK TË UV-SË**
**PROF.DR. ROLAND ZISI**

**KËTU**

Bashkëlidhur po Ju përcjellim për miratim të mëtejshëm, nga Senati Akademik, draft-rregulloren e Programit të Përbashkët të Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në Inxhinieri Mekanike midis Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Universitetit Politeknik të Barit.

- Bashkëlidhur gjendet draft-rregullorja përkatëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj.

**DEKANI**
**Prof.As. Hajdar KIÇAJ**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DEPARTAMENTI I INXHINIERIVE DHE TEKNOLOGJISË DETARE

# RREGULLORE

## E PROGRAMIT MËSIMOR TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE "BACHELOR NË INXHINIERI MEKANIKE"

**Program i përbashkët studimi midis Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (UV)dhe Universitetit Politeknik të Barit (PoliBa) ne gjuhen angleze.**

VLORË 2023

## KREU I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### NENI 1

### Baza Ligjore për hartimin e rregullores së programit të studimit

Kjo rregullore është hartuar duke mbajtur në kosideratë:

1. Ligjin Nr 80/2015 datë 22/07/2015 për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.
2. Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave:"Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë.
3. Vendimin nr. 31, datë 29.12.2017, të Këshillit të Ministrave: "Për përcaktimin e kritereve për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë.
4. Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës
5. Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali të Vlorës.
6. Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore
7. Rregulloren e Brendshme te Funksionimit dhe Organizimit te Departamentit te Inxhinierive dhe Teknologjise Detare.

### Neni 2

### Perkufizime

Në këtë rregullore dhe në të gjitha elementet mësimor në programin e studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike (program i përbashkët me Universitetin Politeknik të Barit ne gjuhen angleze), termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **Diplomë** - Dokumenti zyrtar që i jepet studentit në përfundim të programit të studimit, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet akademike të lidhura me të.
- **Grup-lëndë**- Një strukturë akademike dhe administrative organizimi brenda një departamenti, e cila grupon anëtarë të stafit akademik që mbulojnë lëndë të përafërta brenda një fushe të ngjashme studimi.
- **Komponent mësimor** - Veprimtari e strukturuar dhe formale mësimore.
- **Laborator** - Veprimtaria formuese akademike, gjatë së cilës studenti përvetëson dhe provon aftësitë e tij për të eksperimentuar, investiguar,

observuar dhe provuar teori e metoda të caktuara, të planifikuara brenda një lënde të caktuar, e cila mund të vlerësohet me notë dhe me kredite.

- **Lëndë** - Një degë e një fushe shkencore, e organizuar si një disiplinë mësimore e veçantë, që mësohet në mënyrë sistematike gjatë një kohe të caktuar
- **Modul** - Një pjesë e programit të lëndës, i cili përmbledh në mënyrë të logjikshme, të vazhduar, të rregullt dhe të organizuar tematika të ngjashme, që ndërtohet mbi një numër të kufizuar objektivash mësimorë – akademikë që pritet të realizohen nga student
- **Praktikë** - Një veprimtari formuese akademike, që vlerësohet me vlerësim pozitiv ose edhe me note kaluese e me kredite, gjatë së cilës studentit i kërkohet të zgjerojë dhe të aplikojë njohuritë e marra në auditor, për të fituar aftësi shtesë brenda një mjedisi praktik profesional ose artistik, në kuadër të një programi të caktuar studimi, duke plotësuar kërkesa dhe standarde të njohura etike, profesionale e ligjore.
- **Provim i përgjithshëm përfundimtar** - një detyrim akademik, përmbledhës i programit të studimit Bachelor pas kalimit me sukses të të cilit studenti pajiset me diplomën përkatëse.
- **Objektiva formues dhe kompetenca profesionale** - Bashkësia e dijeve, aftësive e kompetencave specifike të fushës, që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit.
- **ECTS** - Europian Credit Transfer System është përcaktimi i kreditit, sipas sistemit Europian të Transferimit të Krediteve të formimit në arsimin e lartë.
- **Marrëveshja e Bashkëpunimit**–Marrëveshje midis Universitetit "Ismail Qemali të Vlorës" dhe Universitetit Politeknik të Barit– Nr 1273 prot, datë 29.06.2023, Nr 52/34 prot, datë 16.03.2023, për zbatimin e programit të përbashkët Diplomë e përbashkët/dyfishtë Bachelor në Inxhinieri Mekanike, sic paraqitet në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.
- **UV** - Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
- **PoliBa** – Universiteti Politeknik i Barit.
- **DITD** - Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
- **FSHTN** – Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore

Neni 3

## Prezantimi i përgjithshëm i programit të studimit, statusidhe baza ligjore për ofrimin etij

Programi mësimor Diplomë e Përbashkët/Dyfishtë"Bachelor në Inxhinieri Mekanike", ne gjuhen angleze, është program i ciklit të parë të studimeve, ofruar nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Fakulteti i

Shkencave Teknike dhe Natyrore, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë (UV) në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit (PoliBa), në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy IAL$^{-ve}$.

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL$^{-ve}$, me anë të këtij programi të dyja palët (UV dhe PoliBa) synojnë të ofrojnë një program ku studentët Bachelor nga Institucioni Vendas që ndjekin studimet në Bsc në Inxhinieri Mekanike do të parazgjidhen nga institucioni vendas për të përfunduar studimet e tyre Bachelor në institucionin pritës.

Në institucionin pritës, studentët pjesëmarrës do të ndjekin lëndët sipas programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike të institucionit pritës.

Referuar pikës I.A.5 të Marrveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL$^{-ve}$, UV dhe PoiBa, të gjitha lëndët që do të frekuentohen nga studentët në Institucionin pritës do të jenë lëndë në nivel diplomimi dhe do të ofrohen në Italisht ose Anglisht për lendët që do frekuentohen në PoliBa, dhe në Anglisht për lëndët që do të frekuentohen në UV.

Referuar pikës I.A.8 të Marrveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL$^{-ve}$, UV dhe PoiBa, studentët e pranuar të institucionittë origjinës do të paguajnë tarifat e shkollimit në institucionin e origjinës. Ata do të jenë përgjegjësvetëm për shpenzimet e tyre të udhëtimit, shpenzimet e jetesës dhe sigurimin mjekësor gjatë periudhës së studimit pënë institucionin pritës, së bashku me çdo shpenzim tjetër.

Programi organizohet në tre vite akademikë (6 semestra)dhe në përfundim të tyre studentët grumbullojnë 180 ECTS dhe marrin diplomë: "Bachelor në Inxhinieri Mekanike", lëshuar në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy IAL$^{-ve}$.

Ofrimi i këtij programi studimi mbështetet në nenin 71 "Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë", nenin 73 "Programet e ciklit të parë të studimeve", nenin 80 "Programet e përbashkëta të studimit" të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin Nr.1 Prot 315 datë 14.01.2020 "Për Dokumenacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" , dhe Udhëzimin Nr.22, Prot 4669/1 datë 03/09/2020, Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Udhëzimin Nr.1, datë 14.01.2020 "Për Dokumenacionin dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin dhe Mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, Degëve të Tyre, Njësive Kryesore dhe Programeve të Studimit, si Dhe Për Ndarjen ose Bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", nenin 62 "Programet e studimeve të ciklit të parë", nenin 68 "Programet e Përbashkëta të Studimit" të Rregullores së Universitetit të Vlorës.

## KREU II –ORGANIZIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Neni 4
### Vizioni i Programit të Studimit

Adresa /Adress: Bulevardi Vlorë-SkeleWeb-site: www.univlora.edu.al Tel. Fax ++355222288 e-mail: info@univlora.edu.al

Nëpërmjet këtij programi studimi synohet të vihet në zbatim vizioni i Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" për diplomimin e studentëve në fushën e Inxhinierisë Mekanike duke siguruar edukim ekselent ne këtë fushë me synim formimin e specialistëve të lartë të fushës së inxhinierisë mekanike me njohuri të avancuara në funksion të zhvillimeve rajonale.

## Neni 5
## Misioni i Programit të Studimit.

Programi i përbashkët/dyfishtë i studimitBsc. në Inxhinieri Mekanike, ne gjuhen angleze synon të ofroj një arsimim në fushën e inxhinierisë mekanike të cilësisë së lartë për të gjithë studentët e Rajonit të Jugut të Shqipërisë dhe me gjerë. Programi ka si synim tu ofroj studentëve një sërë aftësish dhe njohurish që do ti mundësojnë të diplomuarve të kenë një karriere të suksesshme qoftë në aspektin inxhinierik qoftë në aspektin e lidershipit.

## Neni 6

## Objektivat formuese të programit të studimit

Programi i përbashkët/dyfishtë i studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekanike",ne gjuhen angleze midis UV dhe PoliBaka për qëllim që të formoj inxhinierë mekanike që të jenë në gjendje të konceptojnë, projektojnë, zhvillojnë, prodhojnë, drejtojnë dhe mirëmbajnë makineri dhe sisteme mekanike të thjeshta dhe komplekse, që përdoren në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë kryesisht njohuri dhe kompetenca profesionale në disiplinat karakterizuese si me poshtë:

- Projektimin e Sistemeve Fluidike dhe Termike, duke përfshirë përshkrimin, funksionimin dhe karakteristikat e sistemeve fluide dhe termike.
- Mekaniken e Materialeve, duke përfshirë sforcimet, deformimet, lodhjen, thyerjen dhe faktorin e sigurisë.
- Projektimin e Sistemeve Mekanike, duke përfshirë filozofinë e projektimit, materialet inxhinierike, vetitë e tyre, sforcimet e thjeshta ne elementet e makinave, sforcimet përdredhëse dhe përkulëse, teoritë e shkatërrimit, lidhjet e ribatinuara, te salduara, lidhjet me fileto, me kiaveta, bashkueset, boshtet, enët në presion, sustat, kushinetat, rrotat e dhëmbëzuara.

Ky program studimi e aftëson studentin për të vazhduar studimet në programet e studimit të ciklit të dytë.

## Neni 7

**Kuotat, tarifat dhe kriteret e pranimit të studentëve në programin e përbashkët/dyfishtë tëstudimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike midis UV-së dhe PoliBa ne gjuhen angleze.**

1. Pranimi i studentëve në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike ne gjuhen angleze midis UV-së dhe PoliBa, do të bëhet duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, rregulloret dhe aktet e brendshme institucionale të UV-së, si dhe marrëveshjen e bashkpunimit midis UV-së dhe PoliBa.
2. Referuar pikës I.A.4 tëmarrëveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL-ve, institucioni pritës pranon të shumtën 20 studentë në vit nga intitucioni i origjinës (vendas).
3. Para fillimit të cdo viti akademik, UV dhe PoliBa dakortësojnë kuotat maksimale të studentëve që universiteti pritës mund të pranojë.
4. Referuar pikës I.A.8 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL-ve (UV dhe PoliBa) studentët e pranuar të institucionit të origjinës paguajnë tarifat e tyre të shkollimit në institucionin e origjinës.
5. Referuar pikës Referuar pikës I.A.2 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis UV-së dhe PoliBa studentët e UV-së mund tëpërfshihen në programin e përbashkët/dyfishtëtë studimit Bsc. Inxhinieri Merkanike, midis UV-së dhe PoliBa, pasi ata të kenë ndjekur të paktën semestrin e dytë të vitit të parë akademik të programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike në Universitetin e Vlorës dhe të kenë përfituar me sukses 48 kredite ECTS me një notë mesatare të paktës 25.
6. Referuar pikës I.A.3 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis UV-së dhe PoliBa studentët e PoliBa mund të përfshihen në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Merkanike, midis UV-së dhe PoliBa, pasi ata të kenë ndjekur të paktën semestrin e dytë të vitit tëdytë akademik të programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike në Universitetin e Politeknik të Barit dhe të kenë përfituar me sukses 120 kredite ECTS me një notë mesatare të paktën25.
7. Referuar pikës I.A.8/5 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL-ve studentët e UV-së që do të përfshihen në programin e përbashkët/dyfishtë Bsc. Inxhinieri Mekanike,do të duhet të demostrojnë certifikimin e njohjes së gjuhës italiane në nivelin B1.
8. Referuar pikës I.A. 8/6 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy IAL-ve studentët e PoliBa që do të përfshihen në programin e përbashkët/dyfishtë Bsc. Inxhinieri Mekanike do të duhet të demostrojnë certifikimin e njohjes së gjuhës Angleze në nivelin B2.

**Neni 8**

**Procedura e pranimit dhe rregjistrimit në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike midis UV dhe PoliBa ne gjuhen angleze.**

1. Kriteret e pranimit percaktohen nga Matura Sheterore, si dhe kriteret qe percakton MAS. Per kategorine e studententeve te regjistruar per Diplome te Dyfishte aplikohen te njejtat kritere qe parashikohen ne marrveshjen dypaleshe midis Universitetit te Vlores dhe Universitetit Politeknik te Barit, Nr. Prot 1273 date 29.06.2023, Nr 52/34 prot, date 16.03.2022,ne parim sipas procedurave ne fuqi.
   Per ata qe ndjekin qe ne fillim programin Bachelor ne Inxhinieri Mekanike, Diplome e Dyfishte ne gjuhen angleze, studentet e regjistruar paraqesin ne DITD nje kerkese e cila duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm.
   a. Formularin e Aplikimin
   b. Vërtetimin e Studentit
   c. Letrën e Motivimit
   d. Certifikatën e Notave
   e. Certifikatën e njohjes së gjuhës Italiane në nivelin B1 (per ata qe do te ndjekin programin ne PoliBa ne gjuhen italiane dhe te gjuhes angleze B2, per programin ne gjuhen angleze(studentët të cilët nuk e disponojnë këtë certifikatë në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë mundësi që ta dorëzojnë këtë dokument maksimumi deri në 2 javë përpara përfundimit të sezonit të provimeve të semestrit të dytë të vitit të parë akademik)

2. Sipas afatit kohor ne fuqi, një komision AD-HOC i ngritur pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare (DITD) bën rankimin e kanditatëtëve që plotësojnë kriteret sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe përzgjedh paraprakisht kandidatët sipas kuotave maksimale të pranimit të dakortësuara me universitetin pritës (PoliBa).
3. Komisioni AD-HOC i DITD-së përcjell listën emërore të studentëve të përzgjedhur, së bashku me emailet e tyre Koordinatorit Institucional.
4. Referuar pikës I.B të marrëveshjes së bashkëpunimit midis UV dhe Poliba, Koordinatori Institucional i UV-së përcjell listën emërore të studentëve të përzgjedhur nga UV, së bashku me emailet e tyre koordinatorit të programit të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike të Poliba.
5. Referuar pikës I.B të marrëveshjes së bashkëpunimit midis UV-së dhe PoliBa, Koordinatori Institucional i PoliBa përcjell listën emërore të studentëve të përzgjedhur nga PoliBa, së bashku me emailet e tyre koordinatorit të programit të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike të UV-së.
6. Aplikanët nga të dy IAL-të (UV dhe PoliBa) janë përgjegjës për dorëzimin e aplikimit dhe dokumentacionit mbështetës brenda afatit të aplikimit (1 Shtator i cdo viti Akademik).
7. Referuar pikës I.A.8 studentët e intitucionit të origjinës duhet të jenë dhe të regjistrohen në Universitetin pritës të paktën 1 javë përpara fillimit të semestrit në të cilin ata do të fillojnë studimet.

## Neni 9

## Ndërprerja dhe rifillimi i studimeve

1. Referuar nenit 104 të Rregullores së Brendëshme të Universitetit të Vlorës, studenti mund të bëj ndërprerjen e studimeve.
2. Ndërpreja e studimeve mund të bëhet pasi të jetë njoftuar paraprakisht Dekani i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.
3. Ndërprerja e studimeve, me miratimin e organit përkatës, quhet e justifikuar dhe nuk llogaritet në vitet e përsëritura.
4. Çdo ndërprerje e studimeve pa njoftimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore është e barasvlerëshme me mosparaqitjen në proçesin mësimor dhe viti konsiderohet si vit përsëritje.
5. Studenti mund të rifilloj studimet para, apo pas konsumit të lejes, në fillim të cdo semestri, apo në të njëjtën datë pas së cilës ai është larguar. Në cdo rast duhet të ketë përmbushur të gjitha detyrimet që përmban rregullorja e programit të studimit, bachelor në Inxhinieri Mekanike dhe Rregullorja e Brendëshme e Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali".

## Neni 10

## Kreditet ECTS

1. Në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, krediti i formimit i referohet kredit të formimit sipas Sistemit Europian të transferimit të krediteve dhe ECTS dhe shpreh volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore.
2. Në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, 1 krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit.
3. Në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, sasia vjetore e punës së kryer nga studenti gjatë vititakademik është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij.
4. Në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore.
5. Në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe.

6. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm në rast të vlerësimit pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm/semestral me atë përfundimtar.
7. Njohja e plotë apo e pjesshme e krediteve të fituara nga studenti, me qëllim vazhdimin e studimeve në programin e përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, në rast transferimesh, ripranimesh, apo ndjekjes së një programi të dytë të studimeve, bëhet nga njësia bazë Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Rregulloren dhe Statutin e UV-së.

**Neni 11**

**Transferimi i Krediteve**

Referuar pikës pikës I.D të marrveshjes së bashkëpunimit midis UV dhe PoliBa kurset e përfunduara me sukses në institucionin pritës do të rishikohen për efekt tëtransferimit të krediteve në përputhje me udhëzimet e institucionit vendas.

**Neni 12**

**Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë programin e studimit "Bachelor në Inxhinieri Mekanike"**

Programi i përbashkët/dyfishtë i studimit "Bsc. në Inxhinieri Mekanike" ne gjuhen angleze , midis UV dhe PoliBa, përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS, të cilat grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- LËNDË BAZË, ose lëndë të kategorisë A – Lëndët e kësaj kategorie përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme të studentit.
- LËNDË KARAKTERIZUESE, ose lëndë të kategorisë B – Lëndët e kësaj kategorie lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik të studentit.
- LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE, ose lëndë të kategorisëC – Lëndët e kësaj kategorie janë lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashmedhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, si dhe grup-lëndë me zgjedhje;

- LËNDË PLOTËSUESE, ose lëndë të kategorisë D – Lëndët e kësaj kategorie fokusohen në përfitimin e aftësive në gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.
- DETYRIME PËRMBYLLËSE, ose kategoria E – (Provim përfundimtar/Punim diplome).

## NENI 13

### Kodifikimi i lëndëve në programin dhe planin mësimor

1. Lëndët e programit të përbashkët/dysfishtë tëstudimit Bsc. Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, organizohen në formën e planit mësimor, në të cilat lëndët e kategorive të veprimtarive formuese janë të ndara në vite dhe semestra, duke përcaktuar edhe numrin e krediteve ECTS, ngarkesën javore në auditor të studentit (leksione, seminare, laboratore), ngarkesën jashtë auditorit, detyrat e kursit.
2. Lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: departamentin përgjegjegjës përzhvillimin ekursit dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet.

Kështu, përlëndët me kode:

- "EE ..." dhe "EGR ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
- "MAT-E ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Matematikës.
- "FIZ-E ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Fizikës.
- "KIM-E ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Kimisë.
- "CS-E ..."përgjegjës për zhvillimin e tyre ështëDepartamenti i Shkencave Kompjuterike.
- "MEK ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre ështëDepartamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
- "NAV ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare.
- "ENGT ..."përgjegjës për zhvillimin e tyre ështëofrohen nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja.
- "DET ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Shkencave Detare.
- "ECN ..." përgjegjës për zhvillimin e tyre është Departamenti i Ekonomiksit.

Indeksi E tregon që kursi është hartuar për studentët e programeve inxhinierike. Lëndët me kodin 1, zhvillohen në vitin e parë. Lëndët me kodin 2 në vitin e dytë dhe lëndët me kodin 3 zhvillohen në vitin e tretë.

Në Universitetin Politeknik të Barit lëndët ndjekin kodifikimin sipas rregullave të brendëshme të Universitetit Politeknik të Barit.

## NENI 14

## Sylabuset e Lëndëve

1. Përmbajtja tematike e lëndëve, të dhënat mbi lëndën, mënyrën e vlerësimit, kontrolline dijes, literaturën e detyruar etj, paraqiten në syllabyset përkatëse të çdo lënde
2. Sylabusi u bëhet i ditur studendëve me fillimin e zhvillimit të lëndes nga pedagogu përkatës i ngarkuar për të zhvilluar atë lëndë.
3. Formatii Sylabusit, duhet të përmbajë elementët sipas përcaktimeve të shtojcës 2 të Vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave: "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë.

## NENI 15

## Plani Mësimor i programit të përbashkët/dyfishtë të studimit Bsç. në Inxhinieri Mekanike midis Universitetit të Vlorës "Ismail Qemali" dhe Universitetit Politeknik të Barit

1. Plani mësimor i këtij programi të përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, është organizuar në mënyrë të tillë që studentët e të dy institucioneve të ndjekin pjesë të studimeve të tyre në të dyja IAL-të.
2. Studentët e UV-së do të frekuentojnë pranë UV-së vitin e parë të studimeve dhe studentët të cilët rezultojnë se kanë fituar të paktën 48 kredite me një notë mesatare mbi notën 7, si dhe plotësojnë kriteret e tjera të parashikuara nënenin 7 të kësaj Rregulloreje do të vazhdojnë studimet për dy vitet e tjera akademike pranë Universitetit Politeknik të Barit, sipas përcaktimeve të përcaktuar në APPENDIX A të marrëveshjes midis dy IAL-ve(UV dhe PoliBa), shtojaca I bashkëngjitur kësaj rregulloreje.
3. Studentët e Universitetit Politeknik të Barit do të frekuentojnë pranë Poliba vitin e parë dhe vitin e dytë të studimeve dhe studentët të cilët rezultojnë se kanë fituar të paktën 120 kredite me një notë mesatare mbi notën 25 do të vazhdojnë studimet në vitin e fundit akademik pranë Universitetit të Vlorës. sipas përcaktimeve të përcaktuar në APPENDIX B të marrëveshjes midis dy IAL-ve(UV dhe PoliBa), shtojaca I bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

## KREU III – KONTROLLI I DIJEVE DHE RREGULLAT PËR NDJEKJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Neni 16

### Format dhe organizimi i studimeve në programin e përbashkët/dyfishtë“Bachelor në Inxhinieri Mekanike” ne gjuhen angleze midis UV dhe PoliBa

Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e përbashkët téstudimitBsc. nëInxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, ndahen në:

- mësim në auditor (leksione, seminare dhe laboratore),
- studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
- përgatitje provimesh,
- përgatitje e tezës së diplomës
- praktikë profesionale.

### Neni 17

### Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë: kërkim në fushën përkatëse, projekt kërkimor, punë prezantuese, poster. Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

### Neni 18

### Orari i studimit dhe provimeve

Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësimdhënësit.

Orari i përgjithshëm i Universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit.

Orari i provimeve finale/pjesshme duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë parafillimit të sezonit të provimeve (pjesshme/finale).

Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Ora mësimore zgjat 50 minuta

## Neni 19

## Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm deri në masën 75%.
Numri i mungesave të lejuara përllogaritet për gjithë semestrin përkundrejt numrit total të orëve për gjithë kursin dhe jo në bazë të orëve që i takojnë provimeve të pjesshme.
Nëse studenti mungon gjatë zhvillimit të kursit dhe tejkalon numrin total të mungesave të lejuara për gjithë semestrin, atëherë studenti skualifikohet per shkak te mungesave, nuk futet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet mungesë (m) dhe përsërit kursin në semestrin e ardhshëm kur kursi ofrohet.
Shënimi mungesë (m) do të pasqyrohet në procesverbalet përfundimtare nëse studenti ka plotësuar mungesat totale. Nëse studenti ka frekuentuar kursin por nuk paraqitet në provimin e radhës, në procesverbalin e vlerësimit shënohet "Nuk u paraqit". Nëse studenti nuk ka detyrime frekuentimi, por nuk është paraqitur në asnjë prej provimeve të pjesshme duke përfshirë dhe provimin final, në procesverbalin përfundimtar të vlerësimit do të bëhet shënimi "NP" (Nuk u paraqit), në të kundërt do të bëhet vlerësimi me notën përkatëse. Studentët nëkëtë rastnuk mund të regjistrohen në këto lëndë për të ndjekur kursin si përsëritës, por kanë të drejtën të shlyejnë lëndën vetëm me provim, sipas përcaktimeve në këtë rregullore.
Sekretaria mësimore e DITD-së përgjigjet për administrimin e informacionit mbi frekuentimin e studentëve.

## NENI 20

## Rregullat e regjistrimit dhe organizimi i kurseve

Studentët e programit të përbashkët/dyfishtë të studimit Bsc. nëlnxhinieri Mekanike, midis UV dhe PoliBa, regjistrohen online nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Univlora në kurset që i ofrohen sipas planit mësimor.
Çdo lëndë apo kurs ka kodin e vet të përbërë nga tre shkrohja që tregojnë disiplinën apo fushën e studimit, dhe një numër treshifror që tregon se për studentet e cilit vit janë hartuar këto kurse.
Kurset me numra 100-199 janë kurse universitare hyrëse dhe i perkasin lendeve qe jane planifikuar për studentë të vitit të parë. Kurset me numra 200-299 janë të hartuara për studentë të vitit të dytë, ndërsa kurset me numra 300-399 janë të hartuara për studentë që janë në vitin e fundit të diplomimit të ciklit të parë.

